

## **Hapet thirrja për partneritete në gazetari- Pluralizëm dhe për partneritete në gazetari - Bashkëpunim**

Është hapur thirrja për partneritete në gazetari - Pluralizëm dhe për partneritete në gazetari - Bashkëpunim [CREA-CROSS-2025-JOURPART] me afat për dorëzimin e propozime-projekteve deri më 27 shkurt 2025, deri në orën 17:00 (sipas kohës së Evropës Qendrore).

Mediat e pavarura luajnë rol kyç dhe domethënës në shoqëri dhe kontribuojnë në respektimin e parimeve kyçe të lirisë dhe pluralizmit të mediave gjegjësisht pjesëmarrjen e qytetarëve.

Përmes kësaj thirrje, organizatat me përvojë në media do të mund të shpërndajnë fonde për subjektet e mediave të lajmeve në sektorët mediatik që kanë rëndësi të veçantë për demokracinë. Këtu bëjnë pjesë mediat lokale dhe rajonale, mediat në komunitet, gazetaria hulumtuese ose mediat e specializuara në lajmet me interes publik.

Buxheti për thirrjen është 5.2 milionë euro, ku secili projekt i përzgjedhur merr maksimum 2.5 milionë euro. Norma maksimale e bashkëfinancimit nga Bashkimi Evropian është deri në 90% të buxhetit të përgjithshëm të kualifikuar të projektit. Prandaj, aplikantët duhet të bashkëfinancojnë aktivitetet e tyre të projektit edhe nga burime të tjera.

Thirrja përfshin dy tema: (1) Partneritetet në gazetari dhe (2) Bashkëpunim.

### **(1) Thirrje për propozime për partneritete në gazetari – Pluralizëm**

#### **Synimet**

Qëllimi i kësaj thirrje është ruajtja dhe forcimi i pluralizmit mediatik duke mbështetur mediat lokale dhe rajonale, gazetarinë hulumtuese dhe mediat që ofrojnë lajme me interes publik.

Kjo temë fokusohet në ruajtjen e pluralizmit mediatik, i cili është i një rëndësie vendimtare për debatin demokratik dhe pjesëmarrjen e qytetarëve, dhe në veçanti i referohet:

- mediave lokale dhe rajonale që shpesh nuk kanë burime për t'u përshtatur me ndryshimet digjitale;
- gazetarinë hulumtuese dhe media që ofrojnë lajme me interes publik (siç janë mediat e fokusuar në transparencë, çështje ligjore ose angazhim qytetar).

Propozim-projektet duhet domosdoshmërisht të propozojnë program financimi të dedikuar për organizata të tjera mediatike kurse fondet duhet të ndahen për aktivitete që do të kontribuojnë në transformimin e punës së grupeve të synuara, si p.sh:

- risi në redaktimin e mediave (p.sh. formatet, përmbajtja, mbulimi i lajmeve dhe modelet e të ardhurave);
- përmirësimi i shpërndarjes së lajmeve;
- zhvillimi i strategjisë dhe përfshirja e audiencës në ndërtimin e strategjisë së komunitetit;
- zhvillimi i mjeteve teknike që do të zbatohen në temat e përmendura;
- trajnime për temat e përmendura.

#### **Aplikantët e kualifikuar për thirrjen për partneritete në gazetari – Pluralizëm**

Aplikantët e kualifikuar mund të jenë organizata individuale ose konsorciume të përbëra nga të paktën dy aplikantë nga vendet pjesëmarrëse në programin e Evropës kreative. Aplikantët e kualifikuar janë persona juridikë, si shoqatat e mediave, organizatat joqeveritare, organizatat jofitimprurëse, organizatat e shoqërisë civile, organet publike, organizatat ndërkombëtare, universitetet, qendrat kërkimore, fondet e gazetarisë dhe organizatat për trajnimin e punonjësve të medias, fondacionet etj.

## **Ndikimi i pritur**

- Rritja e inovacionit dhe kreativitetit në modelet e biznesit, proceset e produksionit gazetaresk.
- Rritja e qëndrueshmërisë së përmbajtjes gazetareske të krijuar në mënyrë profesionale.
- Rritja e interesit për përmbajtjen gazetareske të krijuar në mënyrë profesionale në grupe të ndryshme sociale, gjuhësore dhe të moshës.

## **Konkretisht, me këtë thirrje pritet:**

- rritjen e rezistencës, pluralizmit dhe pavarësisë redaktuese në nivel të Bashkimit Evropian në sektorë si media lokale, rajonale dhe të përbashkëta, media kërkimore ose media e specializuar në tema me interes publik;
- rritjen e rezistencës së organizatave aktive në sektorin e mediave të synuar dhe mbrojtjen e peizazhit mediatik;
- miratimi progresiv i teknologjive të reja në sektorin e mediave të synuar në masën që ato kontribuojnë në pluralizmin mediatik dhe peizazh të larmishëm mediatik;
- inkurajimi i krijimit të bazave të njohurive për sektorët e mediave që ofrojnë lajme me interes publik (p.sh. zbulimi i zonave me ofertë të dobët të përmbajtjes me cilësi të lartë dhe/ose ku kërcënohet pluralizmi mediatik).

## **(2) Thirrje për propozime për partneritete në gazetari - Bashkëpunim**

### **Qëllimet**

Qëllimi i mbështetjes për propozimet ndërkufitare për bashkëpunim ndërmjet organizatave të mediave të lajmeve në nivel të Bashkimit Evropian është të përmirësojë qëndrueshmërinë ekonomike të mediave dhe të promovojë inovacionin në modelet e të ardhurave, zhvillimin e audiencës dhe standardet teknike.

Aplikantët ftohen të krijojnë bashkëpunim ndërkufitar mediatik. Qëllimi i propozimit mund të jetë zhvillimi i modeleve më të mira të të ardhurave dhe fitimit të parave, qasje të reja për zhvillimin e audiencës, ndërtimin dhe komunitetin e marketingut, zhvillimin e standardeve të përbashkëta profesionale/teknike, lloje të reja të redaksive, rrjete sindikale ose modele të tjera të shkëmbimit të përmbajtjes/të dhënave ndërmjet lajmeve në të gjithë Bashkimin Evropian ose për të ofruar ndihmë për organizatat e vogla mediatike dhe më shumë.

Propozim-projektet duhet të përfshijnë aktivitete që do të kontribuojnë më së miri në objektivat e konsorciumit si ngjarje, trajnime dhe seminare online për punonjësit e mediave, programe shkëmbimi, programe mentorimi, hartimi i praktikave më të mira, zhvillimi i standardeve teknike për të gjithë sektorin, zhvillimi i udhëzimeve dhe standardeve redaktuese, zhvillimi i udhëzuesve praktik, zhvillimi dhe testimi i platformave dhe zgjidhjeve teknike për shkëmbimin e ideve dhe praktikave më të mira, aktivitete promovuese ose aktivitete të tjera që synojnë ruajtjen e qëndrueshmërisë së sektorit, inkurajimin e shkëmbimit të praktikave më të mira ndërmjet operatorëve dhe inkurajimi i mbështetjes për sektorët e mediave që u mungojnë mjetet për t'u përshtatur me mjedisin digjital.

Kur bëhet fjalë për përmbajtjen, propozim-projektet duhet të synojnë rritjen e efikasitetit dhe cilësisë së raportimit përmes bashkëpunimit inovativ gazetaresk. Projektet mund të testojnë metoda dhe formate inovative të prodhimit ose të kontribuojnë në standardet e cilësisë së lartë të prodhimit të mediave në mënyra të tjera bashkëpunuese. Qëllimi i projekteve mund të jetë rritja e shkëmbimit të praktikave më të mira ndërmjet gazetarëve dhe optimizimi i procedurave të punës për zhanret gazetareske që kërkojnë më shumë kohë dhe burime.

### **Aplikantët e kualifikuar**

Aplikantët e kualifikuar janë persona juridikë që mund të jenë shtëpi mediatike jofitimprurëse, publike dhe private (shtypi i shkruar/online, radio/podcast, televizion dhe të tjera) dhe organizata të tjera të fokusuara në mediat e lajmeve (shoqatat e mediave, OJQ-të, fondet gazetareske dhe organizatat e trajnimit dedikuar për punonjësit e mediave dhe të tjerët).

Propozim- projektet i dorëzohen konsorciumeve që bashkojnë të paktën tre partnerë nga të paktën tre vende të ndryshme që marrin pjesë në programin "Evropa Kreative". Duke qenë se thirrja synon të ndikojë në të gjithë sektorin, rekomandohet përfshirja e sa më shumë mediave në propozim-projektet me aktivitetet e tyre.

Konsorciumet transnacionale të organizatave mediatike ftohen të bashkohen për të inkurajuar transformimin e mediave, raportimin e besueshëm dhe përmirësimin e aftësive të profesionistëve në fushën e mediave të lajmeve, për shembull: zhvillimi i standardeve për prodhimin/produksion mediatik, modele të reja biznesi, lloje të reja të gazetave dhe formateve gazetareske, shkëmbimi i praktikave më të mira etj. Ata mund të fokusohen në një (nën)sektor të mediave së lajmeve (p.sh.: TV, radio, shtyp, etj.) dhe/ose një zhanër gazetaresk (p.sh.: gazetari e bazuar në të dhëna (gazetari e të dhënave), gazetari e specializuar dhe të tjera).

**Kohëzgjatja e projekteve:** deri 24 muaj.

### **Mënyra e përgatitjes dhe dorëzimit të propozim-projekteve/aplikimit**

Propozim-projektet përgatiten në përputhje me kriteret dhe kushtet e përcaktuara në dokumentin e thirrjes: NEWS - Journalism Partnerships (CREA-CROSS-2025-JOURPART), Version 1.0, 22 October.

#### **Linqet dhe dokumentet e thirrjes:**

<https://ec.europa.eu/info/funding-tenders/opportunities/portal/screen/opportunities/topic-details/CREA-CROSS-2025-JOURPART-PLURALISM?isExactMatch=true&status=31094501,31094502&frameworkProgramme=43251814&order=DESC&pageNumber=1&pageSize=50&sortBy=startDate>

[https://ec.europa.eu/info/funding-tenders/opportunities/docs/2021-2027/crea/wp-call/2025/call-fiche\\_crea-cross-2025-jourpart\\_en.pdf](https://ec.europa.eu/info/funding-tenders/opportunities/docs/2021-2027/crea/wp-call/2025/call-fiche_crea-cross-2025-jourpart_en.pdf)

Aplikacionet përpunohen dhe dorëzohen në mënyrë elektronike nëpërmjet **Funding &Tenders Opportunity Portal (F&TP)**. Informacione për qasje në **F&TP** mund të gjeni në:

[https://www.eacea.ec.europa.eu/grants/how-get-grant\\_en](https://www.eacea.ec.europa.eu/grants/how-get-grant_en)

**Më shumë informacione rreth thirrjes mund të merrni në sesionin online të organizuar nga Komisioni Evropian që do të mbahet më 14 nëntor 2024 nga ora 14:00 deri në 15:30..**

Për pjesëmarrje në online sesionin mund të paraqiteni në këtë link: [Creative Europe-MEDIA and Cross sectoral 2025](#)